6. INSTRUMENTAT PËR TË KUALIFIKUAR PUNËN E SHËRBIMIT NË SHTËPI

Orientimi në rrjetin e shërbimeve

e-miliaromagna
innovazione naturale

Regione Emilia-Romagna
Assessorato alle Politiche Sociali. Immigrazione. Progetto giovani.
Cooperazione internazionale

opuscolo 6 albanese.indd 1 16-03-2004 16:35:58

Realizimi është bërë nën kujdesin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Politikave Sociale - Shërbimi i Planifikimit dhe Zhvillimit të Shërbimeve Sociale dhe Shoqërore-sanitare - Dega e të Moshuarve dhe e të Paaftëve në fushën e iniciativave të projektit të integruar për të ndihmuar daljen në pah dhe kualifikimin e punës së asistentëve familjarë në ndihmë të të moshuarve dhe të paaftëve.

Tekstet e broshurave janë përpunuar në bashkëpunim me:

Federica Aleotti *Psikologe – Njësia Lokale e Shërbimit Kombëtar Sanitar (AUSL), Reggio Emilia*

Maria Grazia Battistini *Asistente Sociale – Komuna e Cesena (FC)*

Silvia Bellettini *Përgjegjëse për Aktivitetet Asistenciale – Shërbimi i Asistencës për të moshuarit (SAA), Modena*

Susanna Beltrami *Përgjegjëse për Aktivitetet Asistenciale - Shërbimi i Asistencës për të moshuarit (SAA), Modena*

Andrea Fabbo *Mjek Gjeriatër – Njësia Lokale e Shërbimit Kombëtar Sanitar (AUSL) Modena, Distrikti Mirandola (MO)*

Agnese Fabbri *Infermiere - Njësia Spitalore e Gjeriatrisë – reparti për shtrimin afatgjatë Post Akut dhe Rehabilitimin Ekstensiv – Spitali S.Orsola-Malpighi Bologna*

Diana Gavioli *Asistente Sanitare - Njësia Lokale e Shërbimit Kombëtar Sanitar (AUSL) Modena, Distrikti Mirandola (MO)*

Saadia Lafhimi *Mediatriçe linguistike-kulturore – Komisioni për të Drejtat e Barabarta "Mosaico", Zona Bazzanese (BO)*

Letizia Lambertini *Bashkërenditëse e Komisionit për të Drejtat e Barabarta "Mosaico", Zona Bazzanese (BO)*

commissione pari opportunità mosaico zona bazzanese

Eliana Lombardi *Terapiste e rehabilitimit - Njësia Spitalore e Gjeriatrisë – reparti për shtrimin afatgjatë Post Akut dhe Rehabilitimin Ekstensiv – Spitali S.Orsola-Malpighi, Bologna*

Mohammed Louhui *Presidenti i AMIL – Shoqata e mediatorëve linguistiko-kulturor, Bologna*

Marinella Richeldi *Kordinuese përgjegjëse e Shërbimit Social, Modena*

Eros Rilievo *Përgjegjës i zonës sociale - Formimi (MO)*

Sara Saltarelli *Asistente Sociale - Kooperativa Sociale (Cooperativa Sociale) "Dolce", Bologna*

Chiara Scarlini *Asistente Sociale - Komuna Mirandola (MO)*

Roberta Sordelli *Përgjegjëse Salle Njësia Spitalore e Kirurgjisë – Spitali i Bazzano (BO)*

Referues i projektit:
Simonetta Puglioli *Dega e të Moshuarve dhe e të Paaftëve - Rajoni Emilia Romagna*

Përkthimet, ilustrimet dhe shtypi nën kujdesin e:
Tracce s.r.l.

Broshura e përkthyer në rusisht-polonisht-anglisht-arabisht-rumanisht-frëngjisht-spanjisht-shqip dhe në Italisht mund të shkarkohet nga interneti në adresën:
http://www.emiliaromagnasociale.it/ - seksioni i të moshuarve (anziani).

Orientimi në rrjetin e shërbimeve

Rajoni Emilia Romagna ka krijuar një rrjet kapilar dhe të shumëllojshëm të Shërbimeve Sociale dhe Sanitare. Kjo karakteristikë lind nga nevoja për t'i dhënë përgjigje kërkesave të shumta të një popullate të moshuar dhe të paaftë në rritje të vazhdueshme dhe nevoja të ndryshme.

A) Shërbimet për personin e moshuar

Në qoftë se personi i moshuar ka nevojë për Shërbimet Sociale Sanitare, mund t'i drejtohet dy figurave referuese: **MJEKUT TË FAMILJES** (medico di famiglia) dhe **ASISTENTIT SOCIAL** (assistente sociale) të Komunës ku ka vendbanimin. Këto dy figura kanë kompetenca të ndryshme por kanë lidhje ndërmjet tyre.

Asistenti social zakonisht mund të gjendet pranë komunës, në qoftë se kjo e fundit është me madhësi të vogël ose të mesme, ose pranë lagjes/distriktit në qoftë se është me dimensione të mëdha (Kryeqendër e Provincës). Mund të merren informacione në lidhje me praktikat burokratike dhe për shërbimet që vijojnë:

- **Servizio assistenza infermieristica domiciliare** (SAD) [Shërbimi i asistencës shtëpiake] furnizohet nga operatorët e specializuar që shkojnë në shtëpinë e personit të moshuar ose të paaftë për: shërbime të higjienës personale dhe/ose **të zgjimit** (alzata) të përditshëm; banjo; **mobilizimin** (mobilizzazione) e personit të shtruar; furnizimin e vakteve të ngrënies; transportin pranë strukturave sanitare dhe shoqërime të ndryshme; përmbushjen e praktikave dhe bërjen e pazarit (shpenzimet e javës).
- **Servizi Ricreativi e Culturali** [Shërbime Zbavitëse dhe Kulturore] (Qendrat sociale, Qendrat për të moshuarit që vetëvendosin, Universiteti i moshës së tretë, kopështe, etj) që kanë funksionin e ndenjjes në shoqëri, të dëfrimit dhe nxitjes së bagazhit kulturor të personit.
- **Servizi offerti da associazioni di volontariato** [Shërbimet e ofruara nga shoqatat e vullnetarëve] si

opuscolo 6 albanese.indd 3 16-03-2004 16:36:07

opuscolo 6 albanese.indd 4 16-03-2004 16:36:07

transporti i personave që janë në gjendje të ecin, të shoqërimit, të kryerjes së porosive të vogla, etj.

- **Servizio Assistenza Anziani** (SAA)
  [Shërbimi i Asistencës për të Moshuarit] ku personeli i kualifikuar vlerëson nevojat e të moshuarit dhe në rast se është e nevojëshme aktivizon një grup profesionistash (Servizi di Valutazione Geriatrica – Shërbimi i Vlerësimit Gjeriatrik) për të përgatitur një procedurë kure të personalizuar.
- **Centri diurni** [Qendrat ditore] ku të moshuarit mund të kalojnë ditën së bashku me operatorët që organizojnë aktivitetet kargëtuese dhe rehabilituese.
- **Strutture residenziali** [Strukturat e banimit], pra shtëpitë e mbrojtura dhe banesat sanitare të asistencës, ku mund të shtrohen personat e moshuar që nuk mund të asistohen në shtëpi.
- Servizi per persone con **demenza** [Shërbimi për personat me demencë] për këshillime në lidhje me problemet e veçanta.
- **Invalidità Civile** [Invaliditeti Civil]
  (Assegno di Accompagnamento) [Pagesa për Shoqërimin]. Në qoftë se i moshuari ka nevojë për ndihma ekonomike ose për **Mjete ndihmëse** (ausili – shtrat të lëvizshëm, karrocetë, panolone, dyshekë dhe jastëk kundra plagëve nga ndenjja shtrirë, ngritës), mund të kërkohet njohja e **invaliditetit civil** (invalidità civile) zyrës kompetente të AUSL-it [Ndërmarrja Sanitare Lokale].

opuscolo 6 albanese.indd 5 16-03-2004 16:36:09

Mjeku i familjes (ose Mjeku i Mjeksisë së Përgjithshme) mund të kontaktohet me telefon ose duke shkuar tek ambulatori i tij. Mjekut të Familjes i drejtohemi për probleme që kanë lidhje me shëndetin e të asistuarit, për udhëzime në lidhje me ilaçet, për certifikata që mund të na nevojiten (kërkesa për invaliditet civil) dhe për të sinjalizuar të gjitha ndryshimet e **gjendjes së shëndetit** (stato di salute) psiko-fizike të personit.

Në qoftë se personi për të cilin kujdesemi nuk ka mundësi të shkojë te ambulatori, Mjeku i Familjes mund të shkojë në shtëpinë e të sëmurit pasi të jetë thirrur për të bërë vizitat në shtëpi të cilat ai vetë i ka caktuar, për të kontrolluar gjendjen e shëndetit dhe/ose **përshkrimin e ilaçeve** (prescrizione di farmaci), për analiza me instrumenta dhe për vizita të veçanta.

Mjeku i Familjes ka kompetencë që të aktivizojë Shërbimet e mëposhtëme:

1) **Assistenza Domiciliare Integrata** (A.D.I.)
[Asistencë Shtëpiake e Integruar] kur nevoja për asistencë përfshin operatorët e Shërbimeve Sanitare dhe Sociale të ndryshme, të cilët organizohen për t'u kujdesur për personin në shtëpi.

2) **Assistenza infermieristica domiciliare** (S.A.D.I.)
[Asistenca infermiere shtëpiake] e cila kryen vetëm shërbime që kanë lidhje me infermierinë, të tilla si:
   - **mjekime** (medicazioni)
   - kurat për kateterin e fshikëzës (për kontrollin e urinës)
   - kurat për **ndërhyrjet venoze** (accessi venosi) qendrore;
   - kurat për ndërhyrjet venoze periferike (p.sh. fleboklizë, marrje)
   - administrimi i pajisjeve për terapinë e dhembjes (infuzion)
   - kurat e **stomive** (stomie – ndërhyrje direkte në organet e brendshme)
   - edukim sanitar për një përdorim të rregullt të mjeteve ndihmëse, për mobilizimin dhe pozicionimin e personit të shtruar për të parandaluar ulçerat nga ndenjja për një kohë të gjatë në shtrat dhe dhënia e ilaçeve
   - mbajtja e familjes, kur ngarkesa e asistencës është tepër e rëndë dhe familja rrezikon të kalojë në krizë.

opuscolo 6 albanese.indd 6 16-03-2004 16:36:10

3) Vizitat tekk specialisti (Visite specialistiche)
si ambulatoriale, kur personi shoqërohet tek ambulatori i mjekut specialist për vizitë, ashtu edhe shtëpiake, kur mjeku specialist shkon në shtëpinë e personit.

Është e nevojshme të njohim vendet më të afërta (duhet pyetur familiari ose mjeku i personit të asistuar) të:

- **Centro unico di prenotazione** (CUP)
  [Qendra unike e prenotimit] është vendi ku caktohen prenotimet për vizitat tek specialisti dhe analizat e laboratorit.
- **Struttura Amministrativa Unitaria di Base** (SAUB) [Struktura Administrative Unitare e Bazës] Për zgjedhjen e mjekut të familjes, autoriziki për mjetet ndihmës (p.sh. panoloni, shtrat të lëvizshëm), kura termale (llixha), etj.

B) Shërbimet për asistenten familjare

Edhe asistentja familjare ka disa nevoja të cilave i përgjigjen shërbimet e ndryshme:

- **Shërbime për formimin** (formazione) – që i përkasin kurseve të gjuhës italiane për qytetarë të huaj (pranë Komunave), kurse formimi që i drejtohen personave që kujdesen për të moshuarit ose invalidët.
- Praktikat në lidhje me punësimin dhe me **kontratën e punës** (contratto di lavoro) kryhen pranë:
  - **Sindakatave** (Sindacati) që i kanë zyrat lokale në të gjithë territorin rajonal;
  - **Centri territoriali per l'impiego** [Qendrave territoriale për punësim];
  - **Centri stranieri** [Qendrat për të huajt] ose shërbimet e imigracionit ;
  - **Punti di orientamento/informazione/consulenza** [Pikat e orientimit/informacionit/konsultimit] që shumë Komuna po i aktivizojnë në bashkëpunim me Shërbimi i Asistencë për të Moshuarit (SAA).

opuscolo 6 albanese.indd 7 16-03-2004 16:36:10

C) NUMRAT E URGJENCËS (emergenza)

Mund të thirren nga çdo aparat telefonik, pa pasur nevojë për prefiks dhe janë pa pagesë

• **Emergenza sanitaria** [Urgjenca Sanitare].....**118**

Ky numër duhet thirrur në situatat e vështirësive të mëdha; për shembull: dyshim për **thyerje** (frattura), **humbje e ndjenjave** (perdita di conoscenza), **vështirësi** e madhe **për të marrë frymë** (difficoltà respiratoria), **dhembje e fortë** (dolore acuto) dhe e padurueshme. Gjatë thirrjes është e rëndësishme të përcaktohet:

- adresa (rruga, numri i shtëpisë, komuna);
- numri telefonik nga i cili thërrasim;
- arsyeja e thirrjes,
- kushtet e personit që ka nevojë për ndihmë.

• **Vigili del Fuoco** [Zjarrfikësat].....**115**

Ky numër duhet të thirret në rast **zjarri** (incendio), kur nuk kemi mundësi që të hyjmë në banesën e personit (për shembull, në rast se mbetemi pa dashje jashtë derës së shtëpisë, pa pasur mundësi që të gjejmë çelësat në një periudhë kohe pak a shumë të shkurtër).

• **Carabinieri**.....**112**

• **Polizia** [Policia].....**113**

Këto numra duhen thirrur në rast rreziku të madh ndaj sigurisë personale dhe të personave të asistuar (për shembull, kur shohim **hajdutë** (ladri), kur ka veprime të dhunshme).

opuscolo 6 albanese.indd 8 16-03-2004 16:36:11

SKEDA E NUMRAVE TË DOBISHËM

• **Të afërmit e personit të asistuar**
(duhen pyetur ato personalisht)

1) .....

2) .....

3) .....

4) .....

5) .....

6) .....

• **Mjeku i personit të asistuar** (duhen pyetur të afërmit)
Mund të kontaktohet nga dita e hënë deri të premten, nga ora 8 deri në orën 20, të shtunën dhe në ditët para festave nga ora 8 deri në orën 10.

Dott. .....

Ambulatori:.....

.....

N° i telefonit: .....

Celulari: .....

• **Guardia Medica** [Mjeku i Rojës]
(duhet pyetur mjeku ose të afërmit)
Është një shërbim që zëvendëson mjekun e familjes, për këtë arsye mund ta kontaktojmë nga e hëna deri të premten nga ora 20 deri në orën 8, nga ora 10 e të shtunës deri në orën 8 të ditës së hënë dhe ditët para festave në të njëjtat orare të ditës së shtunë.

N° i Telefonit: .....

opuscolo 6 albanese.indd 9 16-03-2004 16:36:11

• **Centrali i Komunës së Vendbanimit** (mund të gjendet në listën e numrave telefonikë nën zërin "Comune"/"Municipio" - "Komuna"/"Bashkia" ose duhen pyetur të afërmit)

N° i telefonit: .....

• **Asistenti Social i Komunës**

N° i telefonit: .....

• **Servizio Assistenza Anziani**
[Shërbimi i Asistencës për të Moshuarit]

N° i telefonit: .....

• **RAA** (Responsabile Attività Assistenziali)
[Përgjegjës i Aktiviteteve të Asistencës] i referimit (gjendet brenda SAA-ve, ose kujdestar në sektorin e kurseve të formimit për konsultime në lidhje me problemet e asistencës)

N° i telefonit: .....

Celulari: .....

Në qoftë se për të moshuarin kujdeset:

• **Servizio assistenza infermieristica domiciliare** (SADI)
[Shërbimi i asistencës për infermierinë shtëpiake] pyesim mjekun e familjes ose të afërmit.

N° i telefonit: .....

Shkëputet përgjatë vizës së shënuar me ndërprerje

opuscolo 6 albanese.indd 10 16-03-2004 16:36:11

opuscolo 6 albanese.indd 11 16-03-2004 16:36:12

Regione Emilia-Romagna
ASSESSORATO ALLE POLITICHE SOCIALI
www.emiliaromagnasociale.it

opuscolo 6 albanese.indd 12 16-03-2004 16:36:12